



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Aktiv” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.B., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë- Departamenti Fiskal KF.nr.221/22 të datës 22.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Miratohet si e bazuar ankesa e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë- Departamenti Fiskal KF.nr.221/22 të datës 22.02.2023, Prishtet dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Dhoma e Shkallës së Parë, me aktgjykimin e ankimuar, nën pikën I. të dispozitivit ka vend osur, Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Aktiv” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.B., avokat në Prishtinë. Nën pikën II. Anullohet pjesërisht vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë nr.134/2021 i datës 24.05.2021 dhe atë vetëm sa i përket gjobës dokumentit MFA2R00000129088/29.08.2018 në shumë prej 1,000.00€ për mos lëshim të kuponëve fiskal. Nën pikën III. Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë që paditësit “Aktiv” ShPK me seli në Prishtinë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat V.B. në Prishtinë, ta liroj nga gjoba sipas dokumentit MFA2R00000129088/29.08.2018 në vlerë prej 1,000.00€ sa i përket mos lëshimit të kuponëve fiskal. Nën pikën IV. mbetet në fuqi vendimi nr.134/2021 i datës 24.05.2021 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, sa i përket gjobës tjetër sipas dokumentit MFA2R00000129087/29.08.2018 në vlerë prej 1,000.00€. Ndërsa nën pikën V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë e paditura, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të ligjit material si dhe shkeljeve procedurale, me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë të nxjerrë aktgjykim, të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e të paditurës ATK, të anulohet aktgjykimi KF.nr.221/22 i datës 22.02.2023 i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, të mbetet në fuqi vendimi nr.134/2021 i datës 24.05.2021 i Administratës Tatimore të Kosovës, ose të nxjerrë aktvendim të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, të prishet aktgjykimi KF.nr.221/22 i datës 22.02.2023 i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), nenit 81.H të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr.134/2021 të datës 24.05.2021, në pikën I. të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën nr.134/2021 për subjektin “Aktiv” ShPK me numër fiskal (NRF) 601250187 me pronar/drejtor z. G.E., me adresë “Nëna Terezë” pn- Prishtinë në ri procedurë sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore A.nr.2880/18 të datës 16.01.2021 në mbështetje të nenit 77 paragrafi 7 të Ligjit m nr.03/L-222 “Për Administratën Tatimore dhe Procedurat” në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit nr. 03/L-222 “Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”. Nën pikën II. Vendimi nr.1383/2018 i datës 29.08.2018 gjegjësisht dy “Dokumentet e Vendosijes së Ndëshkimeve” në vlerë prej 1,000.00€ (2x 1000=2,000.00€), gjithsejtë 2,000.00€ të datës 29.08.2018 të lëshuara sipas nenit 53.6 të Ligjit nr. 03/L-222, vërtetohen si të bazuara.

Paditësi, i pa kënaqur me vendimin e lartcekur ka ushtruar padi për konflikt administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e vendimit të saj dhe kërkon që i njëjti të anulohet si jo ligjor.

Dhoma e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit kontestues të paditurës, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit “Aktiv” ShPK me seli në Prishtinë, dhe ka anuluar pjesërisht vendimin vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë nr.134/2021 i datës 24.05.2021 dhe atë vetëm sa i përket gjobës dokumentit MFA2R00000129088/29.08.2018 në shumë prej 1,000.00€ për mos lëshim të kuponëve fiskal. Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, ndër të tjera është theksuar se; Gjykata ka vlerësuar se e paditura me rastin e marrjes së vendimit të kontestuar është dashur që të ketë parasysh aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.2880/2018 i datës 26.01.2021, me të cilin aktgjykim gjykata në rivendosje e ka obliguar të paditurën që të deklarohet lidhur me provat mbështetëse të raportit AU005 të datës 08.08.2018 dhe pas kësaj të vlerësoj drejtë gjendjen faktike në kuptim të evidentimit të përgjegjësisë ndaj subjektit në procedurë këtu paditësit për shkeljet eventuale-kundërvajtje administrative për mos lëshimin e kuponëve fiskal siç është konstatuar në vendimin nr.1383/2018 të datës 29.08.2018. po ashtu, gjykata e ka obliguar të paditurën që eventualisht në ri procedurë të vërteton përgjegjësinë kundërvajtëse si më lartë atëherë të konstatoj saktë qarkullimin e vitit të kaluar fiskal me qëllim të llogaritjes së ndëshkimit administrativ, e me këtë edhe aplikimit të drejtë të dispozitave ligjore në kuptim të asaj se cili element konstituiv i dispozitës së paragrafit 2 të nenit 53 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat është përmbushur për të ardhur në shprehje aplikimi i drejtë i ndëshkimit sipas paragrafëve vijues të këtij neni. Gjykata ka konstatuar se e paditura gabimisht ka vendosur kur subjektit në procedurë i ka shqiptuar dy gjoba në shumën prej 1,000.00€ secila për (2) kuponët fiskal, gjithsejtë në total prej 2,000.00€, pasi që e paditura në këtë rast nuk ka konstatuar se këtu paditësi është recidivist në mënyrë që të aplikohet neni 43 paragrafi 103.2 e jo neni 43 paragrafi 103.1 i Udhëzimit Administrativ 15/2010, andaj gjykata ka vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit duke e liruar subjektin në procedurë këtu paditësin nga njëra gjobë në vlerë prej 1,000.00€, duke lënë në fuqi vetëm një gjobë në lartësi prej 1,000.00€ si ndëshkim sikur vetëm një kupon nuk është lëshuar. Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat

gjenden në shkresat e lëndës por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes dhe duke i shqyrtuar vendimin e organit të paditur, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjen se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim i gabuar i të drejtës materiale nga neni 184 i LPK-së, dhe si tillë është jo i drejtë.

Kolegji i kësaj gjykate duke vlerësuar ankesën e paraqitur kundër aktgjyimit të Dhomës së Shkallës së Parë KF.nr.221/22 të datës 22.02.2023, si dhe shkresave të tjera të lëndës konstatoi se, aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n), neni 182 par.1, neni 8 dhe 160.4 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, e që përfaqësojnë shkas për prishjen e këtij aktgjykimi.

Për arsyet e lartcekura, aktgjykimi i kundërshtuar është dashtë të anulohet dhe çështja ti kthehet Dhomës së Shkallës së Parë në rigjykim, për t'i eliminuar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës administrative, që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjyimit të kontestuar. Në ri procedurë, Dhoma e Shkallës së Parë, duhet ti mënjanoj të metat e cekura me lartë, duke vepruar sipas rregullave procedurale kontestimore, ti vërtetoj faktet relevante dhe provat që lidhen me pretendimet e paraqitura në ankesë, të vlerësoj dhe analizoj të gjitha provat e nevojshme konform nenit 7 dhe 8 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që janë me rëndësi për vendosjen e rastit konkret. Pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe mënjanimi të shkeljeve esenciale të lartpërmendura, gjykata e shkallës së parë ka mundësi të bie aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.564/23, me datë 16.04.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami